



Të nderuar të ftuar,
E nderuar Znj. Zv/Guvernatore,
Të nderuar bashkëpunëtorë dhe pjesëmarrës,

Dua ta nis fjalën time me një parantezë të shkurtër. Në prill të vitit 2017 kur mora detyrën time si një nga drejtuesit e Autoritetit isha i vetëdijshëm që së bashku me pjesën tjetër drejtuese do të përballësua me problematika të mbartura dhe shumë sfida të reja. Për më tepër, kur në një mjedis financiar mbizotërues është dinamizmi, përballimi i sfidave kërkon plane veprimi afatgjata.

Për këtë arsye, hartuam Strategjinë 5-vjeçare si një domosdoshmëri, jo vetëm për institucionin, por edhe për kalimin në një stad tjetër të tregjeve financiare në vendin tonë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka kënaqësinë sot t'iu prezantojë Strategjinë për Zhvillimin e AMF-së dhe Tregjeve nën Mbikëqyrje, për vitet 2018-2022, si një angazhim serioz i Autoritetit për të zbatuar një plan veprimi konkret që do të ndërmarrim së bashku në pesë vitet e ardhshme.

Hartimi i strategjisë është mbështetur në:

- Një analizë konkrete e të saktë për situatën aktuale të tregjeve e të mbikëqyrjes së tyre,
- Përgjegjësitë që lindin nga proceset integruese, si dhe nga;
- Modele suksesi të zhvillimit të tregjeve financiare në Evropën Juglindore.

Ne duhet të pranojmë pa hezitim realitetin e sotëm:

- Kemi tregje financiare të pazhvilluara;
- Potenciale të pashfrytëzuara për investitorët dhe ekonominë, si dhe;
- Besimi në tregje dhe kultura financiare e publikut është në nivele të ulëta.

Njëkohësisht, duhet të jemi besimplotë, që nëse guxojmë së bashku, ne mund t'i japim një ndryshim rrënjësor tregjeve nëpërmjet bashkimit të energjive pozitive të të gjitha aktorëve dhe faktorëve në këto tregje për të arritur objektivin kryesor të strategjisë:

Nga tregjet më të brishta financiare në Ballkanin Perëndimor në tregun më të konsoliduar për të qenë lider të rajonit drejt proceseve integruese në BE.

Sot ne kemi klimën e nevojshme për të arritur objektivat e secilit prej grupeve të interesit:

- Ministria e Financave dhe Qeveria e kanë në prioritet zhvillimin e tregjeve financiare si pjesë e projektit të zhvillimit ekonomik për të arritur 5% në rritjen ekonomike;
- Investitorët dhe aksionarët janë shumë entuziastë për zhvillimin e tregjeve;
- Ne si Autoritet jemi të vetëdijshëm që duhet të vazhdojmë të përmirësohemi me ritme më të shpejta;
- Partnerët ndërkombëtarë presin ndryshimet e duhura, duke na mbështetur në çdo hap tonin, si dhe;
- Publiku pret shumë e më shumë.

Këto objektiva bashkohen në një pikë: **mbrojtja konsumatore dhe e investitorit.**

Mbrojtja, fuqizimi dhe edukimi financiar i tyre është një prej prioritetet tona. Nga muaji tetor 2017 ne kemi filluar zbatimin e strategjisë për rritjen e edukimit financiar me një plan konkret veprimi, që është integruar në këtë strategji.

AMF synon, që nëpërmjet ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse dhe rregulluese, të rivendosë besimin e konsumatorit në tregjet financiare, me qëllim sigurimin e integritetit të këtyre tregjeve si një faktor me ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në strategji janë vendosur disa elementë prioritarë, si sfida të zhvillimit afatmesëm:

- Zhvillimi i tregjeve dhe përparimi i tyre me ritëm të shpejtë;
- Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes nga Autoriteti;
- Inovacioni teknologjik që do të lehtësojë nevojat në rritje të konsumatorit dhe investitorëve;
- Hartimi dhe miratimi i një kuadri ligjor të harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian.

Sot, ju kemi paraqitur strategjinë sintezë me planin e veprimit për vitin 2018. Strategjia e detajuar është shumë më voluminoze dhe përmban 72 rekomandime që ne i kemi kthyer në 72 prioritete që do të jenë objekt i punës sonë të përbashkët në 5 vitet e ardhshme.

Ne synojmë që zbatimi i kësaj strategjie të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe eficient, duke krijuar njëkohësisht stabilitet afatgjatë, si dhe duke i dhënë mundësi krijimit dhe zhvillimit të produkteve inovative.

Autoriteti është i bindur se zbatimi i kësaj strategjie, e shoqëruar çdo vit me prioritete të qarta e me një plan konkret veprimi, do të transformojë tregjet financiare që AMF mbikëqyr, duke i kthyer në promotor të zhvillimit ekonomik të vendit, si dhe Autoritetin në një model pozitiv të funksionimit të një mbikëqyrjeje efektive.

Jam besimplotë, që së bashku do të arrijmë ta zbatojmë këtë strategji me sukses, dhe në fund të çdo viti do të bëjmë bilancin, si dhe nëse është e nevojshme përshtatjen e strategjisë me zhvillimin dhe dinamikën e tregjeve përgjatë një viti.

Ne jemi shumë të hapur dhe do e vlerësonim çdo sugjerim tuajin, çdo vërejtje tani e më vonë për ta përmirësuar e për të pasur një strategji konkrete, realiste e të zbatueshme.

Dhe së fundmi më lejoni të bëj një falënderim të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e kësaj strategjie duke e nisur me:

- Grupin Këshillimor të hartimit të Strategjisë, Rinaldin, Brunën, Rezartën, Matielin dhe Albën për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre;
- Partnerët Ndërkombëtarë, Bankën Botërore, FMN, SECO (Sekretariatit për Çështjet Ekonomike të Qeverisë Federale të Zvicrës) dhe konsulentët e projektit për këshillat e vyera;
- Ministrinë e Financave, si dhe;
- Drejtuesit dhe ekspertët e tregjeve financiare për mendimet e tyre.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen!